



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 1/2014**

8 janar 2014

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloret e AAC-së, në vijim:

- Rregullore për zbatimin e Shtojcës 3 në Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet Meteorologjike

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik nga data 29 nëntor deri më 21 dhjetor 2013. Marrja e komenteve dhe vërejtjeve të palëve të interesit për këto projekt-rregullore është bërë duke aplikuar procedurën e paraparë në nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 (konsultimi me shkrim) duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar kushtet për organizimin e takimit me palët e interesit, siç parashihet me nenin 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012.

AAC ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes çdo koment/sugjerim të dhënë në lidhje me projekt-rregulloren në konsultim publik të palëve të interesit.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i është përgjigjur një person fizik, i cili ka paraqitur vërejtjet/sugjerimet e tij nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Rradhitja e shqyrtimit të komenteve/sugjerimeve është bërë në bazë të radhitjes kalendarike të pranimit të komenteve dhe/ose sugjerimeve nga palët, nëpërmes adresës elektronike.

Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për secilën projekt-rregullore, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur vërejtjet e bëra me ndërhyrje në tekst të projekt-rregulloreve, pa ndonjë koment përkatës:

- **Projekt-Rregullore për zbatimin e Shtojcës 3 në Konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil për Shërbimet Meteorologjike**

1. (Neni 4 Pika 4.1.3)

“Si informatë, ne përdorim të dhënat e qendrave botërore për parashikim, në përputhshmëri me Aneksin 3.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

1. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4 Pika 4.1.3 e Projekt-rregullores thotë:

“Kapitulli 3 Sistemi i parashikimit në nivel botëror dhe Shërbimet Meteorologjike, Pika 3.1 – Qëllimi i Sistemit të parashikimit në nivel botëror, Pika 3.2 Qendrat e parashikimit në nivel botëror, nuk janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.”

Kërkesat e Shtojcës 3 të ONAC-ut të specifikuar në Kapitullin 3, Pika 3.1 dhe Pika 3.2 janë të zbatueshme vetëm mbi Qendrat (“WAFC”) që ofrojnë shërbime të parashikimit meteorologjik në kuadër të sistemit për parashikimin e motit në nivel botëror, dhe shtetet kontraktuese që kanë pranuar një përgjegjësi të tillë. Si rrjedhojë dhe duke pasur parasysh vërejtjen nga z. Gosalci, komenti pranohet. Neni 4 Pika 4.1.3 do të largohet nga verzioni final i projekt-rregullores.

2. (Neni 4 Pika 4.1.5)

“Ne jemi obligativ në respektimin e VAAC, që në këtë rast ne jemi nën përgjegjësinë e VAAC Toulouse, siç ishte rasti në vitin 2010 me aktivizimin e vullkanit në Islandë.”
(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

2. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4 Pika 4.1.5 e Projekt-rregullores thotë:

“Pika 3.5 – Qendrat e këshillimit ndaj hirit vullkanik, Pika 3.6 Qendrat shtetërore të vëzhgimit, Pika 3.7 Qendrat shtetërore për këshillim ndaj cikloneve, nuk janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.”

Kërkesat e Shtojcës 3 të ONAC-ut të specifikuar në Kapitullin 3, Pika 3.5 janë të zbatueshme vetëm mbi Qendrat (“VAAC”) që ofrojnë shërbime të njoftimit në lidhje me hirin vullkanik në kuadër të sistemit për monitorimin e vullkaneve në nivel botëror, dhe shtetet kontraktuese që kanë pranuar një përgjegjësi të tillë. Si rrjedhojë dhe duke pasur parasysh vërejtjen nga z. Gosalci, komenti pranohet. Neni 4 Pika 4.1.5 do të largohet nga verzioni final i projekt-rregullores.

3. (Neni 4 Pika 4.1.17 dhe 4.1.18)

“Për arsye se nuk kemi mbi-fluturime, ne nuk prodhojmë SIGMET dhe AIRMET. Poashtu wind shear warnings nuk lëshojmë për shkak të mungesës së pajisjeve për matjen e shear-it.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

3. Përgjigje e AAC-së:

Kërkesat e Shtojcës 3 të ONAC-ut të specifikuar në Kapitullin 7 në lidhje me SIGMET dhe AIRMET, Paralajmërimet për aerodromin dhe Paralajmërimet dhe Alarmet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), në veçanti pikat 7.1 dhe 7.2 që kanë të bëjnë me AIRMET dhe SIGMET

përcaktojnë informatat që duhet të ofrohen në lidhje me parashikimin e ndodhive meteorologjike në vijat ajrore për mbikalime “en-route”. Meqë për momentin nuk ka fluturime “en-route” në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, nuk ka nevojë që zyrat meteorologjike të përgatisin dhe ofrojnë këtë lloj të informatave meteorologjike. Megjithatë kur në një të ardhme të afërt do të krijohet nevoja për informata të tilla, mesazhet AIRMET dhe SIGMET duhet të përpilohen dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e specifikuara në pikat e lartcekura.

Sipas kërkesës së Shtojcës 3 të ONAC-ut të specifikuar në Kapitullin 7 pika 7.4 në lidhje me Paralajmërimet dhe Alarmet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear):

“Paralajmërimet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear) do të përgatiten nga zyra meteorologjike e aerodromit e përcaktuar nga autoriteti përkatës meteorologjik për aerodromet në të cilat ndryshimi i erës “wind shear” konsiderohet si faktor, në harmoni me marrëveshjet lokale me njësitë përkatëse të KTA-së dhe operatorët. “

Duke pasur këtë parasysh, rrjedh se ky lloj i paralajmërimit nuk është i domosdoshëm në ato aerodrome ku “wind shear” nuk paraqet faktor domethënës. Megjithatë, duke pasur parasysh vërejtjet e z. Gosalci, rekomandimi i referuar në pikën 4.1.18 nuk ka nevojë të kthehet në standard. Neni 4 Pika 4.1.18 do të largohet nga verzioni final i projekt-rregullores.

4. (Neni 4 Pika 4.1.25)

“Këtë pikë do ta kisha eliminuar meqë këto qendra janë të krijuara vetëm në zonat tropikale, Evropa nuk posedon me qendër të tillë meqë nuk është zonë tropikale.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

4. Përgjigje e AAC-së:

Komenti pranohet. Neni 4 Pika 4.1.25 do të largohet nga verzioni final i projekt-rregullores.

5. (Neni 4 Pika 4.1.52)

“Përsëri pjesa në lidhje me wind shear është e pazbatueshme për momentin meqë nuk kemi pajisje për matje.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

5. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4 Pika 4.1.52 thotë:

“Pika 4, Dispozitat specifike të ndërlidhura me Raportimin e Ndryshimit të Erës (Wind Shear) dhe të hirit vullkanik, Nën-pika 4.1 Raportimi i Ndryshimit të Erës (Wind Shear), Rekomandimi 4.1.1 dhe Rekomandimi 4.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.”

Ndërsa në Shtojcën 3 të ONAC-ut, pikat e lartcekura specifikojnë kërkesat në lidhje me raportimet e fluturakave gjatë ballafaqimit me fenomenin e “wind shear” në fazën e ngritjes “climb-out” dhe të afrimit, dhe nuk adresojnë çështjen e parashikimit të këtij fenomeni nga zyrat e designuara meteorologjike.

6. (Neni 4 Pika 4.1.62 dhe 4.1.63)

“Ndoshta do të kishte me qenë e udhës që pikat ku përmendet zbatimi për AIRMET dhe SIGMET të përmbledhen në një pikë në të cilën do të përmendej zbatueshmëria në momentin e aplikimit apo prodhimit dhe distribuimit të tyre.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

6. Përgjigje e AAC-së:

Shih përgjigjen nën pikën 3.

7. (Neni 4 Pika 4.1.69 dhe 4.1.70)

“Nuk mund të bëhet detektimi kur nuk ka pajisje për të detektuar, si rrjedhojë për momentin është e pazbatueshme.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror “Adem Jashari”, dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

7. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4 Pika 4.1.69 thotë:

“Pika 6, Specifikimet e ndërlidhura me Paralajmërimet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), Nën-pika 6.1 Zbulimi i Ndryshimit të Erës (Wind Shear), Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.”

Neni 4 Pika 4.1.69 thotë:

“Pika 6, Specifikimet e ndërlidhura me Paralajmërimet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), Nën-pika 6.2 Formati dhe shpërndarja e Paralajmërimeve dhe Alarmeve për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), Rekomandimi, 6.2.3, Rekomandimi 6.2.4 dhe Rekomandimi 6.2.6, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.”

Duke pasur parasysh vërejtjet e z. Gosalci, rekomandimet e lartcekura nuk ka nevojë të kthehen në standarde. Neni 4 Pika 4.1.69 dhe 4.1.70 do të largohen nga drafti final i projekt-rregullores.

8. (Neni 4 Pika 4.1.90 , 4.1.91 dhe 4.1.92)

“Ende nuk posedohet me pajisjen për transmetimin e VOLMET, është në planifikimet buxhetore për të ardhmen. Për momentin nuk ipet shërbimi në mungesë pajisje.”

(Dërguar nga Sherif Gosalci, Menaxher Divizioni Meteorologjik, ANP-Kontrolli Ajror "Adem Jashari", dt. 20 dhjetor 2013, ora 17:02 min).

8. Përgjigje e AAC-së:

Komenti pranohet. Neni 4 Pika 4.1.90 , 4.1.91 dhe 4.1.92 do të largohen nga verzioni final i projekt-rregullores.

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloret nën pikën I të këtij raporti, janë vlerësuar gjithsejt 8 vërejtje/komente të cilat janë pranuar nga data 29 nëntor-21 dhjetor 2013.

Nga këto vërejtje/komente, janë pranuar nga ana e AAC-së gjashtë (6) vërejtje për adaptim/përmirësim të tekstit të rregullores (kommentet nr. 1, 2, 3, 4, 7, 8) të cilat do të inkorporohen në verzionin përfundimtar të projekt-rregullores. Të gjitha komentet tjera kanë marrë përgjigjet adekuate.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Zyra për Çështje Juridike dhe Rregullatore